



Datë/a:	29.08.2018
Për/ Za/ To:	N.P.SH. Doni Term. Drenas
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.08.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “N.P.SH. Doni Term, Drenas”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shpimi i puseve dhe ndertimi i sistemit të ujitjes për gjelbrim”, me Nr. të Prok: 616 18 4902 521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik “N.P.SH. Doni Term, Drenas”, të dt. 27.08.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shpimi i puseve dhe ndertimi i sistemit të ujitjes për gjelbrim”, me Nr. të Prok: 616 18 4902 521, kundër *vendimit të Autoritetit Kontraktues*, të datës 23.08.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 23.08.2018.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 16.07.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shpimi i puseve dhe ndertimi i sistemit te ujitjes per gjelbrim”, me Nr. të Prok: 616 18 4902 521, procedura e hapur.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 06.08.2018. Janë dorëzuar gjithsej 3 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të tenderëve.

Me datë 23.08.2018, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit te prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për tenderuesit e suksesshëm/pasuksesshëm dhe eliminuar.

OE “N.P.SH. Doni Term, Drenas”. me dt. 23.08.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shpimi i puseve dhe ndertimi i sistemit te ujitjes per gjelbrim”, me Nr. të Prok: 616 18 4902 521, kundër vendimit te AK , në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:*

Neni 1: Qëllimi

Neni 6: Ekonomiciteti

Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 56: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e Kontratave

Neni 58: Hapja e tenderëve

Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 60: Kriteret për dhënie te Kontratës

Neni 61: Tenderët jonormlaisht te ulet

Neni 39.8: Udhëzimi Administrativ A01

I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon OE “N.P.SH. Doni Term, Drenas”, Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e tenderëve ne

përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. **Neni 1: Qëllimi** - sipas këtij neni qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. AK e ka respektuar këtë nen duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me teulet e poentim dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhënë asnjë argument se është shkelur kjo dispozite.
2. **Neni 6: Ekonomiciteti** - sipas këtij neni të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. AK e ka respektuar këtë nen duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me teulet e poentim dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhënë asnjë argument se është shkelur kjo dispozite.
3. **Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi** - sipas këtij neni AK është i obliguar që do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, gjë të cilën AK e ka respektuar, duke trajtuar te gjithë OE ne mënyre te barabarte, dhe ka shpërblyer me kontrate OE që ka përmbushur te gjitha kërkesat e parashtruara ne DT dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhënë asnjë argument se është shkelur kjo dispozite.
4. **Neni 56: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e Kontratave** - sipas këtij neni AK është i obliguar që do vlerësoj tenderët ne përputhje me kërkesat parashtruara ne DT, gjë të cilën AK e ka respektuar dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhënë asnjë argument se është shkelur kjo dispozite.
5. **Neni 58: Hapja e tenderëve - Ju informojmë se AK gjate hapjes se tenderëve ka respektuar ne përpikëri nenin 56.11 te RUOPP dhe ka lexuar çmimin e shënuar ne Formularin e Dorëzimit te tenderëve. Ne rastin konkret ne Formularin e dorëzimit te tenderëve, 2 OE kane plotësuar si duhet formularin dhe AK ka lexuar si duhet çmimin e poentuar ndërsa nga oferta juaj ka lexuar çmimin e pa peshuar sepse ky është çmimi te cilin ju e keni vendos gabimisht ne Formular sepse ne Formular do te duhet te shënohej çmimi i peshuar. Neni 56.11 e RUOPP përcakton:**
56.11 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasite indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet te përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pargu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje te veturave, mirëmbajtje te gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike te ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim te vlerësimit te ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi.


Shuma e sigurimit te ekzekutimit te kontratës ne këto raste duhet te përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime te raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës.

Gjithashtu ju informojmë se Çmimet e lexuar gjate hapjes se tenderëve përputhen me çmimet ne Formularin e dorëzimit te tenderëve, por i vetmi defekt është ai i platformës elektronike i cili ka përzier presjen dhe piken dhjetore.

6. Neni 59: "Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve" – sipas këtij neni AK është i obliguar qe do vlerësoj tenderët ne përputhje me kërkesat parashtruara ne DT, gjë te cilën AK e ka respektuar. OE pretendon se ne Formularin e Dorëzimit duhet te vendoset Çmimi për njësi e JO Çmimi i poentuar. Ju informojmë se AK gjate vlerësimit te tenderëve ka respektuar ne përpikëri nenin 56.11 te RUOPP dhe ka vlerësuar çmimin e poentuar. Ky nen përcakton:

56.11 Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasite indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet te përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë qe Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pargu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje te veturave , mirëmbajtje te gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike te ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim te vlerësimit te ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit te ekzekutimit te kontratës ne këto raste duhet te përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime te raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës.

Për me tepër ne pjesën C, Seksioni II, te DT, Lista e çmimeve është përcaktuar kjo kërkesë. Shih me poshtë dëshminë.



AK ka pranuar 3 oferta:

Lot 1

Nr.	Niti & Caja Company	DPV DRILL&BURIMI COM	DONI TERM - DRENAS
Çmimi i total	1,144.50	4,432.50	1,880.00
Çmimi total i peshuar	21.20	119.56	31.72

Lot 2

Nr.	Niti & Caja Company	DPV DRILL&BURIMI COM	DONI TERM - DRENAS
Çmimi i total	132.50		317.90
Çmimi total i peshuar	14.60		30.00

Gjate hapjes publike, ne përputhje me nenin 56.11, është lexuar çmimi total i poentuar (peshuar) për te dy Kompanitë: Niti & Caja Company dhe DPV DRILL&BURIMI COM ndërsa për ju është lexuar çmimi total i pa peshuar (ashtu siç e keni vendos ju gabimisht ne Formular te dorëzimit te tenderit).

Gjithashtu ju informojmë se vlerësimi është kryer ne përputhje me nenin 56.11 e RUOPP i cili përcakton ...*Ne këto raste ne hapje publike te ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben ortem për qellim te cjerësimit te ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Ne këtë rast eshët shpërblyer OE Niti & Caja Company i cili ka ofertuar çmimin me te ulet te poentuar.*

7. Neni 60 "Kriteri për dhënie te kontratës" – sipas këtij neni AK do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; ose 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet, pra ka respektuar nenin 60.1.1 pasi kriteri i shpërblimit ne Njoftimin për kontratë dhe ne DT ka qene tenderi i përgjegjshme me çmimin me te ulet si dhe ka respektuar nenin 52.6 te LPP-se i cili nen përcakton "Në rast të kriterit, tenderi me çmimin më të ulët nuk lejohet konvertimi i çmimeve në pikë dhe të peshohen pikët. Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga

Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm".

8. **Neni 61: Tenderët jonormlaisht te ulet** - ka respektuar këtë nen sepse komisioni i vlerësimit nuk ka konsideruar çmimet e ofruara si çmime abnormale. Kjo ehste competence e AK .
9. **Neni 39.8: Udhëzimi Administrativ A01** - nuk dimë cilit udhëzim i referoheni mirëpo siç u ceke me larte AK ka vepruar ne përputhje me nenin 56.11 te RUOPP i cili nen përcakton se 56.11 *Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasite indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet te përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pargu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje te veturave , mirëmbajtje te gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike te ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim te vlerësimit te ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit te ekzekutimit te kontratës ne këto raste duhet te përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime te raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës.*

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

HEVITU MEKOLU
ASL

